



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIALNr. 9853 prot.Vlorë, më 20.05 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë. _____ 2026

PËR
DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË
PËR MUAJIN PRILL 2026

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, neni 24, neni 30 pika 7, neni 54 pika k dhe n, Ligji nr. 57/2019, datë 18.07.2019, "Për Asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 2 pika b, VKM nr. 597/2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit të kushtëzuar" kreu III, Ligji nr.68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 2 pika 7 si dhe VKB nr.100 datë 23.12.2025, "Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2026", VKB nr. 4 datë 30.01.2026 " Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën", për familjet që nuk i plotësojnë të gjitha kriteret për dhënie të ndihmës ekonomike dhe në bazë të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës ___/05/2026:

VENDOSI:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin Prill 2026, 39 familje me kushte shumë të vështira social-ekonomike, me një fond prej 161.000 (njëqind gjashëdhjetë e një mijë) lekë.

| Nr | NJËSITË ADMINISTRATIVE | NDIHMË EKONOMIKE | |
|----|--------------------------------|------------------|----------------|
| | | Nr | Lekë |
| 1 | Qendra e Bashkisë Vlorë | 27 | 104.500 |
| 2 | Njësia Administrative Shushicë | 3 | 22.000 |
| 3 | Njësia Administrative Qendër | 3 | 13.000 |
| 4 | Njësia Administrative Novoselë | 3 | 12.000 |
| 5 | Njësia Administrative Orikum | 3 | 9.000 |
| | SHUMA | 39 | 161.000 |

2. Familjet që përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë ndodhen në listën bashkëlidhur materialit.
3. Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike

| Nr | Emër | Atesi | Mbiemër | Rajoni | Arsyet përkatëse: |
|----|-----------|-------|---------|----------|---|
| 1 | Eglantina | Veis | Boçi | Shushicë | Del nga skema e ndihmës ekonomike për mosparaqitje. |
| 2 | Flutura | Veis | Latifaj | 2 | Del nga skema e ndihmës ekonomike pasi fillon punë. |

4. Të trajtohen për herë të parë me ndihmë ekonomike

| Nr | Emër | Atesi | Mbiemër | Rajoni | Arsyet përkatëse: |
|----|-----------|--------|---------|--------|--|
| 1 | Hajrie | Haxhi | Sulo | 2 | Qytetarja është në kushte të vështira socio-ekonomike pasi është me probleme të theksuara, familja është me të ardhura të pamjaftueshme, vajza është e mitur vazhdon shkollën dhe ka nevojë për mbështetje. Nisur nga arsyet e lartpërmendura dhe nga verifikimi socio-ekonomik rekomandojmë të trajtohet me ndihmën ekonomike me të ardhurat e Bashkisë. |
| 2 | Violeta | Teki | Binaj | 3 | Qytetarja është kryefamiljare, jeton e vetme në kushte shumë të vështira socio-ekonomike, bashkeshorti i saj vuan dënimin me heqje lirie në një shtet fqinj, ka probleme të theksuara shëndetësore dhe jeton në kushte të vështira banimi. Nisur nga arsyet e lartpërmendura dhe nga verifikimi socio-ekonomik rekomandojmë të trajtohet me ndihmën ekonomike me të ardhurat e Bashkisë. |
| 3 | Gjinovefa | Pashko | Shyti | Orikum | Qytetarja është kryefamiljare e ve jeton e vetme, në kushte shumë të vështira socio-ekonomike dhe shëndetësore dhe për kete arsye po përgatit dhe dokumentacionin për të |

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|---|
| | | | | | perfituar ndihmen e paaftesisë. Nisur nga arsyet e lartpërmendura dhe nga verifikimi socio-ekonomik rekomandojmë të trajtohet me ndihmën ekonomike me të ardhurat e Bashkisë. |
|--|--|--|--|--|---|

5. Ndihma ekonomike të fillojë në datën 01.05.2026 dhe pagesa të bëhet mbas datës 31.05.2026.
6. Masa e pagesës për familjet përfituese përlogaritet sipas V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Per përcaktimin e kriterëve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” kreu III.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social .
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

**ME URDHËR DELEGIMI
NËNKRYETAR**

Joljana Llanaj

